# DËSHMI ARKIVI

**A-438473**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve: I duan rritjet që nga prilli 2023, “prapambetjet” shkojnë në 1 30.5 |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/rama-reagon-serish-per-pagat-e-gjyqtareve-i-duan-rritjet-qe-nga-prilli--i585627` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 14:23:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 14:18:45 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bae20f698d189150abdd11522c9c6202730c238708f97272cc8eec909a911554` |
| TEKSTI | `af8e55dffa47971e9392b280d6c0bcbe0db625d7ca18656428d36ce85824e9a5` |
| PAMJA | `a0ef9e51ad4af0260baa8486a35ec0ea10fcac4650f35c70a015094bf537c71d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fc8c1579e804db5c10ed6cd7e07065043db5db537e18777bb81903eb583b235e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `1ef3995d2b4a1c734844b2b0603a6741e660bf93cde18ce08210f9dd00eaae2d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fc8c1579e804db5c10ed6cd7e07065043db5db537e18777bb81903eb583b235e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve: I duan rritjet që nga prilli 2023, “prapambetjet” shkojnë në 130.5

TemA
12 Shtator 2026, 16:18Politika TEMA



Kryeministri Edi Rama ka reaguar sërish lidhur me vendimin e Gjykatës Administrative për pagat e gjyqtarëve, duke e cilësuar si një vendimmarrje të pazakontë.

Në një postim në platformën “X”, Rama thotë se vendimi nuk lidhet vetëm me rritjen e menjëhershme të pagave me 51%, por edhe me kërkesën për pagesa të prapambetura që prej prillit 2023.

Sipas Ramës, nëse kjo kërkesë do të zbatohej, shuma e detyrimeve të prapambetura do të arrinte në rreth 130.5 milionë euro, ndërsa kryeministri vë në pikëpyetje mënyrën dhe bazën e kësaj vendimmarrjeje.

“Ndjesë për informimin e pjesshëm mbi kuturisjen e djeshme të Gjykatës Administrative, e cila përmes sigurimit të parë të padisë në historinë botërore jo për të ndaluar një akt po për të kryer një akt, nuk kërkon vetëm rritjen e menjëhershme të pagave me 51% për gjykatësit, po edhe “të prapambeturat” që nga prilli 2023, sepse sipas tyre pagat duhet t’u ishin rritur që atëherë aq sa duan t’i rrisin vetë tani.

Gjeni në tabelën bashkëngjitur sa do të merrte çdo gjykatës personalisht në dorë nesër si shumë të prapambetur, sikur ministri i financave të shkelte ligjin dhe të shkonte pas berihajit të kësaj vendimmarrjeje ekstra-parlamentare”, shkruan Rama.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rama, mesazh administratës: Çdo shkelje afati, duhet të ketë përgjegjës dhe kosto]

15:10 Politika / 7 komente

“Drejtësia po godet rendin kushtetues”, Çupi: Gjyqësori në Shqipëri është mësuar me para në xhep

13:10 Politika / 9 komente

SHBA zyrtarizojnë huanë 302 milionë dollarë për Shqipërinë

13:00 Politika / 4 komente

Beteja e fundit për ish-krerët e UÇK! Rama: Liri për çlirimtarët, Thaçi do të triumfojë me forcën e së vërtetës

11:10 Politika / 26 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.